



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 12744/11 prot.

Data: 13, 11, 2024

VENDIM

Nr. 78, Datë 13, 11, 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. Emri i ofruesit të AFP-së: Mesme Profesionale "Petro Sota", Fier.
2. Akti zyrtar i themelimit/licencimit: L525227591F.
3. Organizimi i institucionit: Shkollë mesme profesionale publike.
4. Lloji i ofruesit të AFP-së: Shkollë mesme profesionale.
5. Nipti: L525227591F.

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

konstatoj se:

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin me kusht për kualifikimet profesionale:

- a) "Elektroteknikë" Niveli II i KSHK-së, E-II-21
- b) "Instalime elektrike, civile dhe industriale" Niveli III i KSHK-së, E1-III-21
- c) "Elektroteknikë" Niveli IV i KSHK-së, E-IV-21
- d) "Mekanikë" Niveli II i KSHK-së, F-II-22
- e) "Mirëmbajtje dhe riparime mekanike", Niveli III i KSHK-së, F3-III-18
- f) "Mekanikë" Niveli IV i KSHK-së, F-IV-19
- g) "Shërbime mjeteve transporti" Niveli II i KSHK-së, M-II-21
- h) "Shërbime elektro-auto" Niveli III i KSHK-së, M3-III-22
- i) "Shërbime mjeteve transporti" Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23
- j) "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" Niveli II i KSHK-së, T-II-19
- k) "Zhvillim Website" Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21
- l) "Termohidraulikë" Niveli II i KSHK-së, V-II-20

2. Afati përfundimtar i akreditimit me kusht është 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në përputhje me propozimin përkatës nr.155/10 datë 15.10.2024, dërguar nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

Ofruesi i AFP-së të plotësojë rekomandimet e paraqitura në propozimin përkatës nr.155/10 datë 15.10.2024, ardhur nga AKAFPK-ja, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

